

# Pasqyrat Financiare 2019

“AL-DEMIRAJ” sh.p.k, është themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 03/02/2005. Kapitali aksionar per 2019 është 100000 leke dhe zoterohet nga ortakët I ,Mimoza Demiraj dhe Oresti Demiraj me nga 50% te kutovave ne kapital  
Veprimtaria kryesore Prodhim tregetim materiale te ndryshme te ndertimit Import-Eksport.

## 1. Permbledhje e politikave kontabel

### Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar ‘Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare’ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë pergatitur mbi bazen e parimit te kosos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

**Zbatimi i Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit aplikimi i tyre, sipas kerkesave te SNK-ve, është bere ne menyre perspektive.**

*Ne paraqitjen e pasqyrave financiare te vitit 2019 është zbatuar formati i SKK-2*

**Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:**

### **Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri te mjaftushme ne marrjen e perfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej te tretteve dhe ne te njejtin ushtrim kontabel me te ardhurat e lidhura.

### **Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kosos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2019 janë 1 euro=122.33 leke

### **Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili është i njejte me fitimin kontabel qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, plus shpenzime te panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2019 është 5 %

### **Kërkesat për t'u arkëtuar**

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në

AL-DEMIRAJ

  
AL-DEMIRAJ  
IPT K56321622A  
TILISHT

# Pasqyrat Financiare 2019

vlere), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

## Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

## Aktivet afatgjata materiale

Shoqëria posedon aktive afatgjata materiale dhe jomateriale në zërin Makineri e pajisje

## Gjendjet e inventaret

Vleresimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjelle inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

## 2. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare në banke dhe arke, në leke dhe valute, në datën 31 Dhjetor 2019 janë sipas listës bashkëngjitur:

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike të monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, janë përkthyer në leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit të ushtrimit të bankës respektive.

## 3. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kërkesat e arketueshme dhe aktive të tjera financiare, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabel 2019 deklarohen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme Kliente	3,801,654	1,235,700
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	7,000,000	7,000,000
(iii) Te drejta dhe detyrime ndaj të tregteve	0	0
(iv) Tatim Fitimi	125,461	152,365
(v) teprica e tvsh kreditore në fund të vitit	556,541	1,107,661
Shuma	11,483,656	9,495,726

Në "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme" janë pasqyruar faturat e papaguara për shitjet që shoqëria ka realizuar gjatë ushtrimit.

Drejtimi mendon se të gjitha kërkesat do të arketohen në një periudhë afatshkurter me vlerën e tyre nominale dhe nuk parashikon rënie në vlerë.

## 4. Inventari

AL-DEMIRAJ

AL-DEMIRAJ S.H.  
KIPT K569210224  
DREJTIMI

# Pasqyrat Financiare 2019

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit eshte ne vleren 7849246 leke e cila perbehet nga:

	2019	2018
1. Mallra per Shitje	10759885	11711720
<b>TOTALI</b>	<b>10759885</b>	<b>11711720</b>

Iventari i plote sipas artikujve ne sasi cmim dhe vlere jane bashkangjitur bilancit.

## 5. Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Shoqeria posedon aktive afatgjata materiale sipas listes bashkengjitur.

### Ne Pasivet dhe Kapitalet paraqiten:

#### 2. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fund te ushtrimit kontabel 2019 jane ne vleren 0 leke ne zerin Overdraft prane bankes

#### 3. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Huate dhe parapagimet		
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	332,044	519,561
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	1,560,351	707,736
(iii) Detyrimet sig.shoqerore	50,712	21,762
(iv) Detyrimet tatimore per TAP in	2,600	0
(v) Detyrimet tatimore per Tatim Fitimin	0	0
(v) Detyrimet tatimore per TVSH	0	0
(vii) Debitore kreditore te tjere	0	0
(viii) Detyrimet tatimore per Tatimin ne burim	0	0
Shuma	1,945,707	1,249,059

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per sherbimet dhe materialet e para pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per cdo furnitor.Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" eshte ne vleren 1560351 leke dhe perfaqeson pagat deri ne fund te dhjetorit 2019 per tu paguar ne 2020.

"Detyrimet tatimore per sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimin per sigurimet shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor 2019 ne shumen 50712 leke

"Detyrime tatimore per TAP" perfaqesojne detyrimin per TAP per dhjetorin 2019 ne shumen 2600 leke.

## 6. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

AL-DEMIRAJ

  
AL-DEMIRAJ S. H.  
NIPIT K56321622A  
BILISHT

# Pasqyrat Financiare 2019

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 jane ne shumen 0 leke.

## 7. Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilancin e 2019 eshte 100000 leke

## 8. Fitimi (humbja) e vitit financiar

### ▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 dhjetor 2018
Te ardhura nga shitja e mallrave dhe prod.	13868059	8009991
Te ardhura nga kryerja e sherbimeve (punime)		
Te ardhura nga shitja e mallrave	-	-
Te ardhura te tjera	-	-
<b>Shuma</b>	<b>13868059</b>	<b>8009991</b>

Të ardhurat nga shitja e Mallrave jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

**Shpenzimet e veprimtarise kryesore materiale te konsumuara** jane te perbera nga

Blerje mallrash ne shumen	10792961 lek
Ndryshimi i gjendjes	951835 lek
<b>Totali i shpenzimeve materiale</b>	<b>11744796 lek</b>

### ▪ Shpenzimet te tjera

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
shpenzime trasporti nga te tretet	-	-
sherbime te tjera	10,000	25,325
konsum inventari i imet	-	-
sherbim avokatie	-	41,667
trasmentim kase	13,467	-
nafte	310,000	500,000
parking doganor	-	4,000
mirmbajtje riparime	53,778	-
shpenzime telefonike	-	-
taksa te ndryshme(doganore)	8,073	36,302
gjoba penalitete	-	138,248
taksa bashkije	39,910	84,090
	<b>435,228</b>	<b>829,632</b>

Konsumi i materialeve, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2019 jane treguar ne pasqyren perkatese.

AL-DEMIRAJ

AL-DEMIRAJ SH.N  
RRETHI I TIRANES  
NR. 1022A  
TIRANE  
POLITIKANT

# Pasqyrat Financiare 2019

## ▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Të ardhurat nga interesat (+)	18	4
Shpenzimet per interesa(-)	(26,611)	(24,350)
Fitimet nga kursi i këmbimi(+)	-	-
Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)	-	-
Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668	-	-
<b>Shuma</b>	<b>(26,593)</b>	<b>(24,346)</b>

## ▪ Shpenzime personeli

Shpenzimet e pagave jane si me poshte vijon:

- Pagat e personelit	964300 leke
- Sigurimet shoqerore	159072 leke

## 9. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2019 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2018
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	538,070	507,836
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	-	138,248
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3 Gjoha,penalitete,demshperblime	-	138,248
4 Provizione qe nuk njihen	-	-
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6 Te tjera-materiale jashte perdorimit(pa miratim)	-	-
7 Interes Kredie	-	-
III PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	-	-
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	538,070	646,084
V Shpenzimi i tatim fitimit-5%	26,904	96,913
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	511,167	410,923

## 10. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytzezimit

Asnje ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare. Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare te shoqerise, rezulton se ne ushtrimin 2019 shifra e afarizmit dhe fitimi tregtar. eshte ne nivel te kenaqshem.

AL-DEMIRAJ

  
AL-DEMIRAJ S. H.  
NPT 08321022A  
BILISHT